



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr.19, Datë 09.04.2015

PËR

**“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR VENDODHJEN DHE KUSHTET E TJERA TË
TREGJEVE TË PRODUKTEVE AGRO-USHQIMORE TË SHITJES ME SHUMICË NË
BASHKINË E TIRANËS”.**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/III, shkronja ‘b’, nenit 32, shkronja ‘k’ dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); neni 8, shkronja ‘f’ të ligjit nr.8654, datë 31.07.2000”Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës (indryshuar); udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr.11, datë 02.07.2014 “Për vendodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të shitjes me shumicë”; me propozim të Këshillit Bashkiak Tiranë:

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve që duhet të përmbushin tregjet e produkteve agro – ushqimore të shitjes me shumicë që veprojnë në Bashkinë e Tiranës, si vijon:
 - a. Të jenë pranë akseve kryesore të qarkullimit rrugor dhe lehtësisht të aksesueshëm, në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor dhe krijimit të akseve të përshtatshëm për individët dhe automjetet;
 - b. Të jenë në një distancë jo më pak se 500 m nga zona të miratuara për banim ose pushim;
 - c. Të jenë në largësi jo më të vogël se 1 (një) kilometër, nga çdo zonë me ndotje mjedisore, si psh. fabrika ose impiante që prodhojnë ose shkaktojnë mbetje të dëmshme për shëndetin dhe mbetje kimike, që krijojnë kushte të papërshtatshme për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të produkteve agro-ushqimore;
 - d. Të kenë 2 (dy) porta, një hyrëse dhe një dalje, ku në secilën prej tyre të ketë një hapësirë të posaçme për individët, të ndarë nga hapësira për kalimin ose qarkullimin e mjeteve;
 - e. Numri i magazinave brenda stabilimentit ku është vendosur tregu agro-ushqimor të jetë jo më pak se 10 (dhjetë)
 - f. Të kenë ambiente frigoriferike;

- g. Të kenë ambjente të veçanta për punonjësit;
 - h. Stabilimenti ku është vendosur tregu agro-ushqimor të jetë i rrethuar, të jetë i pajisur 24 orë me ujë e energji elektrike dhe të jetë i garantuar pastrimi dhe sigurimi i kushteve higjienike gjatë gjithë orarit të funksionimit për publikun, si edhe një pastrim i përshtatshëm dhe i vazhdueshëm gjatë orarit kur tregu është i mbyllur, në përputhje me VKB nr.1, datë 05.02.2007 “Për rregullimin e administrimit e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia e Tiranës.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI